



Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 27 janar 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën Referuese të Administratores sipas Pjesës 12(5) të
Direktivës për Mbrojtësit**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Nina Tavakoli
Sofi Menegon

Administratores

Fidelma Donlon

Mbrojtësit Kujdestar për Bashkim Smakajn
Bas Martens

Pjesëmarrësit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtësit Kujdestar për Fadil Fazliun
Mishiel Pestman

Mbrojtësit Kujdestar për Hajredin Kuçin
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 21(4)(e) dhe 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullës 9(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), pjesës 12(5) të Direktivës për Mbrojtësit,² dhe nenit 28(3) dhe (4) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Kodi i Etikës Profesionale”),³ lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Administratorja caktoi Mishiel Pestman (“z. Pestman”) si Mbrojtës Kujdestar për Fadil Fazliun (“z. Fazliu”).⁴
2. Më 18 dhjetor 2024, Administratorja i paraqiti Gjykatës së Procedurës Paraprake një kërkesë referuese, ku kërkonte një vendim prej saj për ekzistencën e konfliktit faktik apo potencial të interesave, duke qenë se z. Fazliu kishte bërë kërkesë që Dejvid Jang (“z. Jang”), i cili më parë kishte përfaqësuar Rexhep Selimin në Çështjen KSC-BC-2020-06 (“z. Selimi” dhe “çështja 6”) (“Kërkesa Referuese”) të caktohej si Mbrojtës i tij.⁵

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BD-04-Rev2, Administratorja, [Directive on Counsel](#) (Direktiva për Mbrojtësit), 22 shkurt 2024.

³ KSC-BD-07-Rev1, Administratorja, [Code of Professional Conduct for Counsel and Prosecutors Before the Kosovo Specialist Chambers](#) (Kod i Etikës Profesionale – për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës), 28 prill 2021.

⁴ KSC-BC-2023-12, F00051, Zyra Administrative, *Njoftim i Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar për Fadil Fazliun* (“Njoftimi i Caktimit”), 6 dhjetor 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00090, Zyra Administrative, *Kërkesë Referuese sipas Pjesës 12(5) së Direktivës për Mbrojtësit*, 18 dhjetor 2024, konfidenciale dhe *ex parte*.

3. Nga 15 deri në 22 janar 2025, pas një urdhri të Gjykatësës së Procedurës Paraprake,⁶ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”),⁷ mbrojtja e z. Fazliu (“Mbrojtja e Fazliut ” dhe “Parashtrimet”),⁸ dhe z. Jang⁹ dorëzuan parashtrimet e tyre në lidhje me Kërkesën Referuese.

II. PARASHTRIMET

A. ADMINISTRATORJA

4. Duke marrë parasysh se z. Jang ka përfaqësuar z. Selimi në çështjen 6 nga 12 nëntor 2020 deri në 13 shkurt 2024, Administratorja i kërkon Gjykatësës së Procedurës Paraprake të marrë vendim nëse ekziston një konflikt faktik apo potencial interesi në rast se z. Jang do të përfaqësonte z. Fazliu në këtë çështje. Administratorja parashtron se ka arsye konkrete që sugjerojnë se çështja 6 lidhet në një masë të konsiderueshme me çështjen aktuale dhe se mund të krijohet një “mbivendosje provash” midis dy çështjeve gjyqësore.¹⁰

B. ZPS-JA

5. ZPS-ja pajtohet me Administratoren se çështja 6 dhe çështja aktuale janë të lidhura në një masë të konsiderueshme dhe parashtron se ka konflikt potencial

⁶ KSC-BC-2023-12, F00099, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Urdhër për Riklasifikim dhe Parashtrime (“Urdhër për Parashtrime”), 20 dhjetor 2024, konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00114, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00099* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 15 janar 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00123, Mbrojtja e Fazliut, *Parashtrime të Fadil Fazliut në lidhje me Kërkesën Referuese sipas Pjesës 12(5) të Udhëzuesit për Mbrojtësit dhe Kërkesë për Zgjatje të Afatit për t’iu Përgjigjur Mocioneve që Presin Përgjigje*, 20 janar 2025, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00118, z. Jang, *Përgjigje ndaj Kërkesës Referuese të Administratores drejtuar Gjykatësës së Procedurës Paraprake sipas Pjesës 12[5] të Direktivës për Mbrojtësit* (“Parashtrimet e z. Jang”), 16 janar 2025, konfidenciale dhe *ex parte*; F00130, z. Jang, *Përgjigje Plotësuese ndaj Kërkesës Referuese të Administratores drejtuar Gjykatësës së Procedurës Paraprake sipas Pjesës 12[5] të Direktivës për Mbrojtësit* (“Parashtrimet Plotësuese të Z. Jang”), konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁰ Kërkesa Referuese, para. 1, 2-5, 13, 15-16.

interesi.¹¹ ZPS-ja thekson, në veçanti, se ka mundësi që z. Jang të ketë marrë informacion konfidencial gjatë përfaqësimit të z. Selimi në lidhje me të njëjtin material që është nxjerrë apo do të nxirret për z. Fazliu.¹²

C. Z. JANG

6. Z. Jang parashtron se, pas një shqyrtimi më të kujdesshëm të ligjit dhe fakteve, nuk ka asnjë konflikt faktik apo potencial interes.¹³ Më konkretisht, z. Jang argumenton se: (i) nuk pretendohet që z. Selimi është përfshirë në ndonjë mënyrë në akuzat kundër z. Fazliu në këtë çështje;¹⁴ (ii) çështja aktuale dhe çështja 6 kanë të bëjnë me akuza tepër të ndryshme dhe çdo lidhje midis tyre është tepër e largët dhe nuk është aq konkrete dhe e veçantë sa për të arritur nivelin e një konflikti apo konflikti potencial interes;¹⁵ (iii) nuk ka prova bindëse se interesat e z. Fazliu janë (thelbësisht) të kundërta me ato të z. Selimi;¹⁶ (iv) atij (z. Jang) nuk i kujtohet informacioni konfidencial që përmend ZPS-ja;¹⁷ (v) ai ka marrë pëlqimin e informuar të z. Selimi për të vepruar në emër të z. Fazliu;¹⁸ dhe se (vi) z. Fazliu ka bërë një zgjedhje të informuar, duke e ditur se z. Jang kishte përfaqësuar z. Selimi.¹⁹

D. MBROJTJA

7. Mbrojtja e Fazliut parashtron se: (i) pyetjes nëse ekziston apo mund të krijohet një konflikt interesi duhet t'i përgjigjet së pari z. Jang, sepse ai është i vetmi person që mund të provojë nëse interesat e klientëve të mëparshëm bien

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹³ Parashtrimet e z. Jang, para. 2, 28.

¹⁴ Parashtrimet e z. Jang, para. 13-15.

¹⁵ Parashtrimet e z. Jang, para. 18-22.

¹⁶ Parashtrimet e z. Jang, para. 23-25.

¹⁷ Parashtrimet e z. Jang, para. 26-27.

¹⁸ Parashtrimet plotësuese të z. Jang, para. 4 dhe Shtojca 1.

¹⁹ Parashtrimet plotësuese të z. Jang, para. 5.

ndesh me ato të klientëve të ardhshëm;²⁰ (ii) thjesht prania e “mbivendosjes” midis çështjes aktuale dhe çështjes 6 nuk është e mjaftueshme për të ardhur në përfundim se ekziston një konflikt interesi;²¹ (iii) ndërhyrja juridike duhet të bëhet në raste të veçanta;²² dhe (iv) në rast se z. Jang do të caktohej si mbrojtës i z. Fazliu, kjo do të ishte në interes të z. Fazliu dhe të drejtësisë.²³

8. Mbrojtja e Fazliut parashtron më tej se Mbrojtësi Kujdestar nuk mund ta përfaqësojë në mënyrë efikase z. Fazliu, duke qenë se ai nuk merr më udhëzime prej tij.²⁴ Për këtë arsye, ajo kërkon zgjatjen e afatit për t’iu përgjigjur të gjitha mocioneve të çështjes, që janë në pritje deri sa të caktohet z. Jang, apo një mbrojtës tjetër (“Kërkesa e Mbrojtjes së Fazliut për Zgjatje Afati”).²⁵ Mbrojtja e Fazliut shton në këtë drejtim se: (i) ekzistojnë arsye të vlefshme, duke qenë se e drejta e z. Fazliu për mbrojtje efikase nga Mbrojtës të Specializuar të zgjedhur prej tij vetë ka më shumë peshë se interesat e një gjykimi të shpejtë dhe (ii) nuk shkaktohet asnjë dëm në këtë fazë shumë të hershme të procesit.²⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

9. Në bazë të nenit 21(4)(e) të Ligjit, i akuzuari gëzon të drejtën që të mbrohet përmes një Mbrojtësi të Specializuar të zgjedhur prej tij.

10. Sipas nenit 39(13) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të nxjerrë ndonjë urdhër tjetër që mund të jetë i nevojshëm për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor të drejtë dhe të shpejtë.

²⁰Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 12.

²¹Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 13.

²²Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 13.

²³Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 14.

²⁴Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 15.

²⁵Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 1, 15-17, 20.

²⁶Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 18.

11. Në bazë të Pjesës 12(5) të Direktivës për Mbrojtësit, përpara se të emërojnë apo caktojnë mbrojtësin, Administratorja mund t'ia referojë Trupit Gjykses përkatës për mendim çdo çështje konflikti potencial interesi të përmendur në nenin 28(3)(b)-(e) të Kodit të Etikës.

12. Në bazë të nenit 28(3)(b) të Kodit të Etikës Profesionale, Mbrojtësi nuk këshillon, përfaqëson apo vepron në emër të një klienti në një çështje para Dhomave të Specializuara nëse është duke këshilluar, përfaqësuar apo vepruar, apo ka këshilluar, përfaqësuar apo vepruar në emër të një klienti tjetër në një çështje para Dhomave të Specializuara që ka lidhje me të në një masë të konsiderueshme.

13. Në bazë të nenit 28(3)(c) të Kodit të Etikës Profesionale, Mbrojtësi nuk këshillon, përfaqëson apo vepron në emër të një klienti në një çështje para Dhomave të Specializuara nëse ka këshilluar, përfaqësuar apo ka vepruar në emër të një klienti të mëparshëm ose interesat e klientit të pritshëm apo të ri janë thelbësisht të kundërta me interesat e klientit të mëparshëm.

14. Në bazë të nenit 28(4)(b)(1) të Kodit të Etikës Profesionale, kur lind një konflikt i mundshëm interesi, sipas nenit 28(3)(b) të Kodit të Etikës Profesionale, në çdo fazë të procedurave, Mbrojtësi njofton Administratoren me shkrim, merr pëlqimin e informuar të çdo klienti që ka gjasë të ketë pasoja, dhe njofton Trupin (Trupat) Gjykses përkatës i cili përcakton nëse ekziston ndonjë konflikt interesi.

15. Në bazë të nenit 28(4)(b)(2) të Kodit të Etikës Profesionale, kur lind një konflikt i mundshëm interesi, sipas nenit 28(3)(c) të Kodit të Etikës Profesionale, në çdo fazë të procedurave, Mbrojtësi njofton Administratoren me shkrim, merr pëlqimin e çdo klienti që ka gjasë të ketë pasoja dhe vlerëson nëse një pëlqim i tillë ka gjasa të cenojë në mënyrë të pakthyeshme administrimin e drejtë dhe të duhur të drejtësisë, përfshirë të drejtën e klientit për një gjykim të drejtë.

16. Sipas rregullës 9(5) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mundet, *proprio motu*, ose kur i tregohen arsye të vlefshme: (a) të zgjasë ose të shkurtojë çdo

afat të përcaktuar në Rregullore ose të vendosur prej panelit ose (b) të njohë si të vlefshëm çfarëdo veprimi të ndërmarrë pas përfundimit të afatit përkatës.

IV. DISKUTIM

A. ÇËSHTJE PARAPRAKE

17. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja e Fazliut i dorëzoi parashtrimet e veta tre ditë pas përfundimit të afatit të vendosur nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.²⁷ Mbrojtja e Fazliut nuk i paraqiti ndonjë kërkesë Gjykatëses së Procedurës Paraprake për zgjatjen e afatit për parashtrimet e veta dhe nuk dha asnjë justifikim për dorëzimin e tyre me vonesë. Megjithatë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi t'i pranonte parashtrimet sikur të ishin bërë në mënyrë të vlefshme, si rast i jashtëzakonshëm, në bazë të rregullës 9(5)(b) të Rregullores, duke marrë parasysh: (i) rëndësinë e çështjes në shqyrtim; (ii) faktin që parashtrimet fillimisht u dorëzuan në kohë, por duhej të ridërgoheshin për shkak të disa gabimeve të shtypit; (iii) se vonesa që pasoi është e vogël; dhe (iv) se parashtrimet do ta ndihmojnë Gjykatësen e Procedurës Paraprake për të marrë vendim.

B. KËRKESA REFERUESE E ADMINISTRATORES

18. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se e drejta e një të akuzuari për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës i specializuar i zgjedhur prej tij është një e drejtë themelore në të cilën nuk duhet të ndërhyhet me lehtësi.²⁸

²⁷ *Shih* Urdhrin për Parashtrime, para. 11(d), që urdhëron Mbrojtjen e Fazliut dhe z. Jang të dorëzojnë parashtrimet e tyre deri të premtën, 17 janar 2025. Mbrojtja e Fazliut i dorëzoi parashtrimet e veta të hënën, 20 janar 2025, at 17:50.

²⁸ *Shih*, përveç nenit 21(4)(e) të Ligjit, nenin 30(5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 6(3)(c) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 14(3)(d) të Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

19. Duke iu kthyer ligjin përkatës të zbatueshëm, Gjykatësja e Procedurës Paraprake sqaron se neni 28(3) i Kodit të Etikës Profesionale përmban baza të ndryshme ligjore për përcaktimin e një konflikti faktik ose potencial interesi. Neni 28(3) i Kodit të Etikës Profesionale parasheh jo vetëm një mekanizëm mbrojtës për eliminimin e konflikteve të interesave pasi ato të kenë lindur, por edhe për parandalimin e konflikteve të tilla para se ato të lindin.²⁹ Rastet e parapara në këto dispozita nuk janë të gjithsejta, por alternative.³⁰

20. Duke iu kthyer veçorive të çështjes, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, ndonëse z. Selimi nuk ndiqet penalisht në çështjen 12 dhe çështja aktuale nuk mbivendoset me çështjen 6 nga pikëpamja e fushëveprimit të akuzave, Aktakuza e Konfirmuar pretendon se personat e akuzuar në çështjen aktuale janë bashkërenduar për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në dëshmitë dhe/për të kontaktuar dëshmitarët e ZPS-së në çështjen 6.³¹ Dëshmitarët e identifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar, të cilët eventualisht mund të thirren nga ZPS-ja të dëshmojnë në këtë çështje, janë (me disa përjashtime) dëshmitarë në çështjen 6.³² Kështu, për mendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, në kundërshtim me parashtrimet e z. Jang,³³ nuk mund të përjashtohet plotësisht se të dy proceset gjyqësore janë “thelbësisht të lidhura”, sipas kuptimit të nenit 28(3)(b) të Kodit të Etikës Profesionale.

²⁹ Po ashtu, KSC-BC-2020-06, F02112, Trupi Gjykses II, [Decision on Defence Counsel Request for Determination Pursuant to Article 28\(4\)\(b\)\(i\) of the Code of Professional Conduct for Counsel and Prosecutors \(Conflict of Interest\)](#) ((Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit për Vendim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët (Konflikti i Interesit)), 8 shkurt 2024, publik, para. 31.

³⁰ E kundërta, Parashtrimet e z. Jang, para. 25.

³¹ KSC-BC-2023-12, F00055/A01, Prokurori i Specializuar, [Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar](#), 6 dhjetor 2024, publike (që përmban Aktakuzën e Konfirmuar).

³² Shih KSC-BC-2023-12, F00087/RED, Prokurori i Specializuar, *Versioni i redaktuar publik i Kërkesës së Prokurorisë për Masa Mbrojtëse dhe Kërkesa në lidhje me To me Shtojcën 1 Rreptësisht konfidenciale dhe Ex Parte*, 10 dhjetor 2024 (data e versionit të redaktuar publik 22 janar 2025), publik, para. 4, me Shtojcën 1 konfidenciale.

³³Parashtrimet e z. Jang, para. 18-22.

21. Edhe në rast se të dy çështjet nuk do të ishin thelbësisht të lidhura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mendon se interesat e z. Fazliu mund të jenë thelbësisht të kundërta me ato të z. Selimi. Ndonëse argumentohet se z. Selimi dhe z. Fazliu mund të përdorin strategji të njëjta apo të pajtueshme,³⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se ky është një parashikim hipotetik, i cili mund të ndryshojë gjatë ecurisë së procesit aktual. Kështu, në mënyrë hipotetike, mund të ndodhë që z. Jang, i cili ka dijeni për provat në çështjen 6 dhe e njeh strategjinë e mbrojtjes së z. Selimi nga koha kur e përfaqësonte, nuk lejohet ta përdorë këtë njohuri për ta përfaqësuar në mënyrë efikase z. Fazliu, për shkak të detyrimeve të vazhdueshme të konfidencialitetit ndaj z. Selimi, gjë që mund në fund të ndikojë negativisht në strategjinë e z. Fazliu. Për mendimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, në kundërshtim me parashtrimet e z. Jang,³⁵ nuk mund të përjashtohet krejtësisht se interesat e z. Fazliu, klientit të tij të ardhshëm, mund të jenë ose të bëhen thelbësisht të kundërta me interesat e z. Selimi, klienti i tij i mëparshëm, sipas kuptimit të nenit 28(3)(c) të Kodit të Etikës Profesionale.

22. Pavarësisht nga këto, për arsyet e mëposhtme, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk beson se ka ndonjë konflikt faktik apo potencial interesi, sipas kuptimit të neneve 28(3)(b) ose (c) dhe (4)(b)(1) dhe (2) të Kodit të Etikës Profesionale, që të pengojnë caktimin e z. Jang si mbrojtës të z. Fazliu.

23. Së pari, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se argumentet e parashtruara nga Administratorja dhe ZPS-ja në lidhje me ekzistencën e një konflikti (potencial) interesi janë tepër hipotetike, spekulative dhe të paqarta për të mbështetur një konstatim të tillë. Edhe vetë Gjykatësja e Procedurës Paraprake po ashtu nuk sheh ndonjë situatë mjaftueshëm konkrete e cila mund të bëhej shkak për lindjen e një konflikti të tillë interesi. Është me rëndësi të

³⁴Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 13.

³⁵Parashtrimet e z. Jang, para. 23-25.

vihet në dukje në këtë drejtim se: (i) pavarësisht nga ndonjë mbivendosje për sa i përket provave, të dy çështjet kanë fushëveprime të ndryshme; dhe (ii) z. Jang nuk është më mbrojtës i z. Selimi. Kështu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk sheh një situatë mjaftueshëm konkrete ku detyra e z. Jang për besnikëri ndaj z. Selimi të mund të cenojë interesat e z. Fazliu apo interesat më të gjera të drejtësisë.³⁶

24. Së dyti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se z. Jang ka marrë pëlqimin e informuar të z. Selimi në lidhje me përfaqësimin e pritshëm të z. Fazliu.³⁷ Sa i takon z. Fazliu,³⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se: (i) ai është në dijeni të përfaqësimit të mëparshëm të z. Selimi prej z. Jang;³⁹ (ii) ai kërkoi që z. Jang të caktohej si mbrojtës i tij me dijeninë e tij;⁴⁰ (iii) ai përfiton nga këshillat e pavarura ligjore të mbrojtësit të tij kujdestar dhe është i lirë të komunikojë me të; dhe (iv) mbrojtësi kujdestar e mbështet caktimin e z. Jang.⁴¹

25. Së treti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se, në rast se lind një konflikt faktik apo potencial interesi, gjithsesi, në çdo fazë të procesit, z. Jang e ka për detyrë të njoftojë Administratoren për të, sipas nenit 28(4) të Kodit të Etikës Profesionale. Ky detyrim shërben gjithashtu për të mbrojtur interesat e z. Fazliu dhe administrimin e duhur të drejtësisë dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka arsye të besojë se z. Jang nuk do t'i përmbahet atij.

26. Mbështetur në sa më lart, dhe duke pasur parasysh të drejtën themelore të z. Fazliu për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës i specializuar i zgjedhur prej tij,

³⁶ KSC-BC-2020-06, F02112, Trupi Gjykues II, [*Decision on Defence Counsel Request for Determination Pursuant to Article 28\(4\)\(b\)\(i\) of the Code of Professional Conduct for Counsel and Prosecutors \(Conflict of Interest\)*](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit për Vendim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët (Konflikti i Interesit), 8 shkurt 2024, publik, para. 22.

³⁷ Shtojca 1 e Parashtrimeve Plotësuese të z. Jang.

³⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se z. Jang kërkoi gjithashtu edhe pëlqimin e z. Fazliu, me anë të Mbrojtësit Kujdestar, por se është "e paqartë se sa mund të zgjasë ky proces"; *shih* Parashtrimet plotësuese të z. Jang, para. 3.

³⁹ Parashtrimet plotësuese të z. Jang, para. 5.

⁴⁰ Kërkesa Referuese, para. 1.

⁴¹ Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 14.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se nuk ka ndonjë konflikt faktik apo potencial interesi që mund të lindë nga caktimi i z. Jang si mbrojtës i z. Fazliu.

C. KËRKESA E MBROJTJES SË FAZLIUT PËR ZGJATJE AFATI

27. Duke u kthyer tek Kërkesa e Mbrojtjes së Fazliut për Zgjatje Afati, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton, për arsyet e mëposhtme, se Mbrojtja e Fazliut nuk ka treguar arsye bindëse që të justifikojnë zgjatjen e afatit, sikundër është kërkuar.⁴²

28. Së pari, Gjykatësja e Procedurës Paraprake kujton se, më 5 dhjetor 2024, Administratorja caktoi z. Pestman si mbrojtës kujdestar të z. Fazliu, në pritje të emërimit apo caktimit të Mbrojtësit të Specializuar.⁴³ Qëllimi i caktimit të mbrojtësit kujdestar është të sigurojë që z. Fazliu të ketë përfaqësim ligjor deri në çastin që emërohet apo caktohet mbrojtësi i specializuar i zgjedhur prej tij.⁴⁴ Gjatë gjithë kësaj periudhe, mbrojtësi kujdestar ka të njëjtat detyra dhe përgjegjësi që duhet të ketë mbrojtësi i specializuar. Kështu, fakti që mbrojtësi i specializuar nuk është caktuar ende për z. Fazliu, nuk përbën “arsye të vlefshme” sipas kuptimit të rregullës 9(5) të Rregullores, që të justifikojë zgjatjen e afatit deri sa të bëhet një caktim i tillë. Kjo gjë do të binte ndesh pikërisht me caktimin e mbrojtës kujdestar.

29. Së dyti, parashtrimi se z. Fazliu është i privuar nga përfaqësimi ligjor është i gabuar. Duke mos i dhënë udhëzime mbrojtësit kujdestar, z. Fazliu në të vërtetë ka zgjedhur të mos ushtrojë të drejtën e tij për të bërë parashtrime apo për t’iu përgjigjur parashtrimeve në këtë çështje, sipas rregullave 75 dhe 76 të

⁴²Parashtrimet e Mbrojtjes së Fazliut, para. 1, 20.

⁴³Njoftimi i Caktimit, para. 2 dhe Shtojca 1.

⁴⁴Shih rregullën 92(1) të Rregullores.

Rregullores. Z. Fazliu është i lirë ta bëjë këtë, të komunikojë me mbrojtësin kujdestar për këtë qëllim dhe të përfitojë nga këshillat e tij ligjore, në pritje të emërimit apo caktimit të një mbrojtësi të zgjedhur prej tij.

30. Së treti, një kërkesë e “përgjithshme” , si ajo e bërë nga Mbrojtja e Fazliut – për zgjatje të të gjitha afateve në lidhje me kërkesat ende të pashqyrtuara – është e papranueshme. Kërkesat për zgjatje afati sipas rregullës 9(5) dhe 76 të Rregullores duhet të jenë konkrete dhe të përligjura si duhet, duke treguar arsyet e ekzistencës së arsyeve të vlefshme për një zgjatje të tillë.

31. Për këto arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e rrëzon Kërkesën e Mbrojtjes së Fazliut për Zgjatje Afati.

V. VENDIM

32. Për arsyet e mësipërme, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **KONSTATON** se nuk ekziston ndonjë konflikt faktik apo potencial interesi nëse z. Jang caktohet si mbrojtës i z. Fazliu në këtë çështje;
- b. **RRËZON** Kërkesën e Mbrojtjes së Fazliut për Zgjatje Afati;
- c. **URDHËRON** Zyra Administrative dhe z. Jang të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre përkatëse F00090, F00118 dhe F00130, ose të kërkojnë riklasifikimin e tyre, deri **të hënën, 10 shkurt 2025**; dhe
- d. **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike parashtrimet F00099, F00114 dhe F00123, aktualisht të klasifikuara si konfidenciale dhe *ex parte*.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhor Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E hënë, 27 janar 2025

Në Hagë, Holandë.